



# Vaksinë për COVID-19

Informacione të rëndësishme për vaksinën AstraZeneca, Vaxzevria

Çfarë mund të prisni pasi të keni bërë vaksinën për COVID-19 Vaxzevria (AstraZeneca)

**Versioni 13**

**28 korrik 2021**



**Rialtas na hÉireann**  
Government of Ireland

## **Rreth kësaj broshure**

Kjo broshurë ju informon rreth vaksinës së COVID-19 (koronavirusit). Informacionet që gjeni këtu janë:

- çfarë është COVID-19
- çfarë është vakcina e COVID-19
- kush duhet ta bëjë vaksinën
- përse është e rëndësishme bërja e vaksinës
- kush nuk duhet ta bëjë dhe kush duhet ta shtyjë bërjen e saj
- siguria e vaksinës dhe efektet e saj anësore
- ku mund të merrni më shumë informacion

**Ju lutemi ta lexoni këtë broshurë me kujdes. Mund të flisni rreth vaksinës edhe me një specialist të kujdesit shëndetësor, si mjeku juaj i familjes (doktori) ose një farmacist.**

## **Çfarë është COVID-19?**

COVID-19 është një sëmundje që mund të prekë mushkëritë dhe rrugët e frymëmarrjes e ka raste edhe pjesë të tjera të trupit. Ai shkaktohet nga një virus që quhet koronavirus.

COVID-19 është shumë ngjitës. Ai përhapet nga ajri përmes spërklave që lëshojnë njerëzit kur kolliten apo teshtijnë, ose kur prekin sipërfaqet ku kanë rënë spërklat, e më pas prekin sytë, hundën ose gojën.

COVID-19 mund të shkaktojë sëmundje serioze, shtrim në spital e madje edhe vdekje.

### **Simptomat e zakonshme të COVID-19 përfshijnë:**

- temperaturë (temperaturë e lartë 38 gradë Celsius e lart)
- kollë e papritur – mund të jetë çdo lloj kolle, jo vetëm e thatë
- marrje fryme ose vështirësi në frymëmarrje
- humbje ose ndryshim i nuhatjes ose shijes – kjo do të thotë se keni kuptuar se nuk mund të nuhasni apo të shijoni më, ose gjërat kanë erë apo shije tjetër

Mund të mos i keni të gjitha këto simptoma, ose mund të mos ndiheni mirë si zakonisht. Simptomat mund të shfaqen deri në 14 ditë pas infektimit. Ato mund të jenë të ngjashme me simptomat e ftohjes ose të gripit.

Nëse keni simptoma të COVID-19, vetizolohuni (qëndroni në dhomën tuaj) dhe bëni një test të COVID-19.

Për më shumë informacion rreth COVID-19, vizitoni **[www.hse.ie/coronavirus](http://www.hse.ie/coronavirus)** ose telefonojini HSELive në numrin **1800 700 700**.

### **Kush është më i rrezikuar nga COVID-19?**

Njerëzit në moshë dhe ata që kanë probleme të caktuara shëndetësore janë më të rrezikuar për t'u sëmurur nëse infektohen me COVID-19.

### **Çfarë është vakcina COVID-19?**

Vaksina është një substancë që duhet të përmirësojë imunitetin (mbrojtjen) nga një sëmundje e veçantë.

Vaksina e COVID-19 do t'ju ofrojë mbrojtje nga COVID-19. Nëse njerëzit vaksinohen, do të reduktohet gjithashtu edhe numri i personave që mund të sëmuren rëndë apo edhe të vdesin nga COVID-19 në komunitetin tonë.

Vaksinat mësojnë sistemin imunitar se si të mbrohet nga sëmundjet. Për sistemin tonë imunitar është shumë më e sigurt të mësojë se si të mbrohet përmes vaksinimit, sesa duke u infektuar me COVID-19.

### **Kush duhet ta bëjë vaksinën?**

Listën e grupeve të personave që do të bëjnë vaksinën mund ta shihni në faqen e internetit:

**[www.gov.ie/covid19vaccine](http://www.gov.ie/covid19vaccine)**

**Edhe pse është në dorën tuaj të vendosni nëse do ta bëni vaksinën, HSE, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Departamenti i Shëndetësisë rekomandojnë që ta bëni sapo t'ju afrojnë.**

Vaksinat do të bëhen pasi të mbërrijnë furnizimet në Irlandë.

Kur të vijë radha juaj, do t'ju informojmë se si ta bëni vaksinën përmes fushatave ose me ftesë të drejtpërdrejtë. Është e rëndësishme që të mos e kontaktoni HSE-në për vaksinimin para këtij momenti.

Përpara se të bëni vaksinën, duhet të lexoni këtë broshurë dhe broshurën informuese të pacientit nga prodhuesi. Broshurën informuese të pacientit nga prodhuesi e gjeni në: **[www.hse.ie/covid19vaccinePIL](http://www.hse.ie/covid19vaccinePIL)**

Keni gjithashtu mundësinë të bisedoni paraprakisht me një specialist të kujdesit shëndetësor. Nëse vendosni të bëni vaksinën, do të jepni miratimin tuaj, i cili do të regjistrohet.

HSE e ofron vaksinën pa pagesë.

### **Përse është e rëndësishme bërja e vaksinës së COVID-19?**

Bërja e një vaksine për COVID-19 duhet të zvogëlojë rrezikun e infektimit me COVID-19 dhe t'ju mbrojë nga komplikacionet serioze të COVID-19. Duke ofruar vaksinën për popullatën, synojmë të mbrojmë njerëzit dhe të zvogëlojmë rastet e sëmundjeve dhe të vdekjeve të shkaktuara nga ky virus.

### **E kam kaluar COVID-19, a duhet ta bëj vaksinën?**

Po. Edhe nëse keni kaluar COVID-19, mund të infektoheni sërish.

Vaksina zvogëlon rrezikun e riinfektimit me COVID-19. Edhe nëse riinfektoheni me COVID-19, vaksina mund të lehtësojë simptomat tuaja.

### **Jam me COVID-19 aktualisht, duhet ta bëj vaksinën?**

Jo. Duhet ta shtyni bërjen e vaksinës derisa të shëroheni nga COVID-19.

### **Bëjeni këtë për:**

- të paktën katër javë pasi të keni vërejtur simptomat e para ose
- katër javë që kur keni rezultuar pozitiv në testin e COVID-19

### **Bërja e vaksinës**

### **Kush është vaksinuesi im?**

Vaksinuesi juaj është personi që do t'ju bëjë vaksinën. Ata janë trajnuar nga HSE për administrimin e vaksinave të COVID-19.

## **A mund të infektosh me COVID-19 nga vakcina e COVID-19?**

Jo. Vakcina e COVID-19 nuk mund t'ju infekttojë me COVID-19. Mund të ndodhë që të jeni infektuar me COVID-19 përpara se të bëni vaksinën dhe të mos kuptoni se keni simptoma deri në momentin e vaksinimit.

Nëse keni simptoma të COVID-19, është e rëndësishme që të vetizoheni (të qëndroni në dhomën tuaj) dhe të planifikoni një test pa pagesë për të zbuluar nëse keni COVID-19.

Nëse keni temperaturë që ju fillon më shumë se dy ditë pasi të keni bërë vaksinën, ose zgjat më shumë se dy ditë, duhet të vetizoheni dhe të bëni një test të COVID-19.

Nëse keni simptoma të COVID-19 pas dozës së parë, duhet ta bëni gjithsesi edhe dozën e dytë. Ndërkohë që merrni një farë mbrojtjeje nga doza e parë, doza e dytë do t'ju ofrojë mbrojtjen më të mirë kundër virusit.



### **A duhet ta bëj vaksinën e COVID-19 nëse kam temperaturë të lartë?**

Jo. Nëse keni temperaturë (38 gradë Celsius e lart) duhet ta shtyni bërjen e vaksinës, derisa të ndiheni mirë.

### **A duhet ta bëj vaksinën nëse jam shtatzënë apo me fëmijë në gji?**

Nëse e keni bërë dozën e parë dhe ushqeni me gji, duhet të bëni dozën e dytë.

Nëse e keni bërë dozën e parë dhe jeni shtatzënë, do ishte e mira ta bënit dozën e dytë pasi të kenë kaluar 36 muaj të shtatzënisë. Nëse nuk e bëni dozën e dytë, rrezikoni më shumë që të sëmureni në gjendje të rëndë.

Për më shumë informacione, vizitoni

**[www.hse.ie/covidvacpreg](http://www.hse.ie/covidvacpreg)**

### **Çfarë vaksine do të më ofrohet?**

Vaksina që ne ofrojmë quhet vaksina Vaxzevria. Kjo vaksinë është prodhuar nga AstraZeneca.

Kjo vaksinë me vektor viral përmban një version të padëmshëm të një virusi tjetër (vektori). Ajo i mëson trupit tuaj se si të prodhojë një proteinë që do të aktivizojë një përgjigje imune.

Më pas, trupi juaj krijon antitrupa që ndihmojnë në luftimin e infeksionit nëse virusi i COVID-19 hyn në trupin tuaj në të ardhmen.

### **A është e sigurt vakcina?**

HSE i vë në përdorim vaksinat, vetëm kur ato përmbushin standardet e sigurisë dhe efektshmërisë.

Ndërkohë që puna për zhvillimin e vaksinave të COVID-19 ka ecur shumë më shpejt se zakonisht, vakcina që ne ofrojmë i ka kaluar të gjitha fazat e zakonshme që nevojiten për zhvillimin dhe miratimin e një vaksine të sigurt dhe efektive.

Për t'u miratuar për përdorim, vakcina e COVID-19 i ka kaluar të gjitha provat klinike dhe kontrollet e sigurisë të cilave u nënshtrohen gjithë medikamentet e tjera të licencuara, duke ndjekur standardet ndërkombëtare të sigurisë.

Vaksina që ne ofrojmë quhet vakcina Vaxzevria, prodhuar nga AstraZeneca. Ajo:

- ✓ është testuar në mijëra persona si pjesë e provave klinike
- ✓ ka rezultuar në përputhje me standardet rigoroze të sigurisë, cilësisë dhe efektshmërisë, si dhe është miratuar dhe licencuar nga organet rregullatore. Në Irlandë, organi rregullator është Agjencia Evropiane e Medikamenteve (EMA) – vizitoni [www.ema.europa.eu](http://www.ema.europa.eu) për më shumë informacion.

### **Si bëhet vakcina e COVID-19?**

Vaksina e COVID-19 bëhet si injeksion në pjesën e sipërme të krahut. Zgjat vetëm pak minuta.

### **Sa doza të vaksinës së COVID-19 do të më duhet të bëj?**

Duhet të bëni dy doza të vaksinës së COVID-19 për të përfituar mbrojtje më afatgjatë. Dozën e dytë do ta bëni 8 - 12 javë pas dozës së parë.

## **Cila janë efektet anësore të vaksinës?**

Si të gjitha medikamentet, edhe vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica e tyre janë të lehta deri mesatare, afatshkurtra dhe nuk shfaqen tek të gjithë.

Më shumë se një në 10 persona mund të kenë:

- ndjesinë e lodhjes
- ndjeshmëri, nxirje të vendit, dhimbje ose të kruara në krahun ku kanë bërë injeksionin e vaksinën
- dhimbje koke
- dhimbje muskujsh
- dhimbje kyçesh
- marrje mendsh
- temperaturë (38 gradë Celsius e lart)

Më shumë se 1 në 100 persona mund të kenë skuqje ose ënjtje të vendit të injeksionit, diarre, të vjella ose numër të ulët pllakëzash gjaku (nuk shoqërohet me asnjë simptomë).

Më shumë se 1 në 1000 persona mund të kenë rënie të oreksit, marrje mendsh, përgjumje, djersitje, ënjtje të gjëndrave limfatike ose të kruara.

Efektet e rënda anësore, si një reaksion i rëndë alergjik, janë shumë të rralla, përkatësisht në rreth 1 në 100 000 persona. Vaksinuesi juaj është trajnuar të trajtojë reaksione të rralla alergjike serioze.

Shumë rrallë tek njerëzit mund të paraqitet mpiksje e gjakut shumë të pazakontë me trombocite të ulëta pas kësaj vaksine. Rreziku i kësaj gjendje shumë të rrallë është më i lartë tek të rinjtë. Shihet afërsisht në 1 në 100,000 njerëz të moshës 50 vjeç e lart, dhe 1 në 50,000 njerëz të moshës 18 deri 49 vjeç. 1 në 5 persona tek të cilët paraqitet kjo gjendje mund të vdesin. Këto mpiksje gjaku ka më pak të ngjarë të raportohen pas dozës së dytë të vaksinës.

Në një numër shumë të vogël kanë ndodhur raste të sindromës së rrjedhjes së kapilarëve tek njerëzit pasi kanë bërë vaksinën. Është serioze por ndodh shumë rrallë dhe ndonjëherë mund të jetë edhe fatale.

Tek një numër shumë i vogël njerëzish është paraqitur Sindroma Guillain-Barre pas kësaj vaksine. Gjendja mund të jetë serioze dhe duhet të trajtohet në spital.

Mjeku i familjes, doktori ose vaksinuesi mund t'ju këshillojë për rreziqet dhe përparësitë e bërjes së vaksinës.

Vaksina e COVID-19 i është nënshtruar të njëjtave prova klinike dhe kontrolleve të sigurisë si gjithë vaksinat e tjera të licencuara, megjithatë vakina është e re dhe informacionet për efektet anësore afatgjata janë të kufizuara.

Sa më shumë persona ta bëjnë këtë vaksinë në Irlandë dhe nëpër botë, aq më shumë informacione do të kemi për efektet e saj anësore. HSE do ta përditësojë këtë informacion rregullisht në faqen tonë të internetit, dhe nëse nevojitet, do te përditësojë broshurat informuese që u jepen njerëzve kur bëjnë dozën e parë ose të dytë të vaksinës.

### **Ethet pas vaksinës**

Është mjaft e zakonshme të keni ethe pas një vaksinimi.

Zakonisht, kjo ndodh brenda dy ditësh (48 orë) nga marrja e vaksinës, dhe zhduket brenda dy ditësh.

Keni më shumë të ngjarë të keni ethe pas dozës së parë të vaksinës.

Nëse ndiheni jo mirë, merrni paracetamol ose ibuprofen siç udhëzohet në kutinë ose fletëpalosjen. Nëse jeni të shqetësuar, ju lutemi kërkoni këshilla mjekësore.

### **Simptomat shumë të rralla të mpiksjes së gjakut**

Edhe pse rreziku i mpiksjes së gjakut me pllakëza të ulëta është jashtëzakonisht i ulët, duhet të keni parasysht shenjat për t'u pasur kujdes.

Kërkoni ndihmën e urgjente të mjekut nëse keni një nga këto simptoma pasi të keni bërë vaksinën Vaxzevria:

- mosmbushje me frymë
- dhimbje në kraharor ose stomak
- ënjtje ose ndjesi të ftohti në një këmbë
- dhimbje koke e fortë ose që përkeqësohet, hutim ose kriza
- gjakderdhje e vazhdueshme, nën lëkurë, ku nuk ka pasur lëndime të mëparshme
- disa nxirje të vogla, pulla të kuqe ose ngjyrë vjollcë, ose filluska gjaku nën lëkurë

Mpiksjet shumë të rralla të gjakut me pllakëza të ulëta janë raportuar përgjithësisht brenda 14 ditësh nga bërja e vaksinës Vaxzevria.

Bëni kujdes ndaj këtyre simptomave gjatë javëve pas vaksinimit.

### **Simptomat shumë të rralla të sindromës së rrjedhjes së kapilarëve**

Sindroma e rrjedhjes së kapilarëve shkakton rrjedhjen e lëngut nga enët e vogla të gjakut. Edhe pse rreziku i kësaj gjendjeje është jashtëzakonisht i ulët, duhet të



keni parasysh shenjat për t'u pasur kujdes.

Kërkoni ndihmën e urgjente të mjekut nëse keni një nga këto simptoma pasi të keni bërë vaksinën Vaxzevria:

- ënjtje e shpejtë e gjymtyrëve (krahëve dhe këmbëve)
- shtim i menjëhershëm në peshë

Mund të ndiheni gjithashtu të këputur për shkak të tensionit të ulët.

Sindroma e rrjedhjes së kapilarëve është raportuar zakonisht brenda 4 ditësh nga bërja e vaksinën Vaxzevria. Bëni kujdes ndaj këtyre simptomave gjatë ditëve pas vaksinimit.

### **Simptomat e Sindromës Guillain Barré**

Sindroma Guillain Barré është një gjendje që prek nervat në trup. Shkakton pezmatim nervi dhe mund të rezultojë në dhimbje, mpirje, dobësi muskulore dhe vështirësi në ecje.

Kërkoni ndihmë urgjente mjekësore nëse:

- keni shikim të dyfishtë ose vështirësi në lëvizjen e syve tuaj.
- keni vështirësi në qëllitje, të folur ose përrypje.
- keni probleme me koordinimin, ndiheni të pasigurt në këmbë ose keni vështirësi në ecje.
- ndjeni dobësi në krahë, këmbë, gjoks ose fytyrë.
- keni mpirje në duar dhe këmbë.
- keni probleme me kontrollin e fshikëzës dhe funksionimin e zorrëve.

Kini kujdes për këto simptoma në javët pas vaksinimit tuaj.

## **A ka njerëz që nuk duhet ta bëjnë vaksinën e COVID-19?**

### **Po. Ju nuk duhet ta bëni vaksinën e COVID-19 nëse:**

- ✘ keni pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj cilitdo përbërësi të vaksinës (duke përfshirë polisorbatin 80). Lexoni broshurën informuese të pacientet nga prodhuesi, për të parë listën e përbërësve.
- ✘ keni pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj një doze të mëparshme të kësaj vaksine.
- ✘ keni pasur mpiksje të gjakut me pllakëza të ulëta pas një doze të mëparshme të kësaj vaksine.
- ✘ keni një historik të sindromit të rrjedhjes së kapilarëve.
- ✘ ju është thënë nga një mjek që nuk duhet të merrni vaksinën COVID-19 Janssen ose vaksinën COVID-19 AstraZeneca Vaxzevria, për arsye mjekësore.

Flisni me mjekun tuaj përpara se të merrni vaksinën COVID-19, nëse keni pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të kaluarën, përfshirë ndonjë vaksinë ose ilaç tjetër.

Shumica e njerëzve mund ta bëjnë vaksinën në mënyrë të sigurt. Personi që do t'ju bëjë vaksinën do t'i përgjigjet me kënaqësi pyetjeve që do të keni në momentin e vaksinimit.

Do t'ju japë gjithashtu një broshurë me këshilla për kujdesin e mëtejshëm, si dhe një kartelë vaksinimi ku shkruhet emri dhe numri i partisë së vaksinës që keni bërë.

### **Unë jam nën 50 vjeç. A duhet ta bëj këtë vaksinë?**

Nëse jeni nën 50 vjeç dhe e keni bërë dozën e parë të vaksinës, duhet ta bëni dozën e dytë mes 4 - 12 javësh.

Nëse nuk keni marrë kurrë vaksinë COVID-19, vakcina Pfizer/BioNTech ose Moderna COVID-19 rekomandohet për njerëzit nën moshën 50 vjeç. Sidoqoftë, EMA ka aprovuar këtë vaksinë për përdorim në moshat 18 vjeç e lart.

Bisedoni me vaksinuesin tuaj, Mjekun ose Farmacistin për rreziqet dhe përfitimet për ju nga marrja e kësaj vaksine.

Nëse e merrni këtë vaksinë, është e rëndësishme të

njihni simptomat e mpiksjes shumë të rrallë të gjakut në mënyrë që të dini se kur duhet të merrni ndihmë mjekësore. Simptomat janë të shënuara në këtë broshurë.

### **Sa kohë duhet që vaksina të ketë efekt?**

Ju do të keni mbrojtjen më të mirë 15 ditë pas dozës tuaj të dytë.

Ekziston ende mundësia që të infektoheni me COVID-19, edhe nëse keni bërë vaksinën.

### **A funksionon vaksina tek kushdo?**

Nëpër botë, vaksinat shpëtojnë të paktën 2 deri në 3 milionë jetë çdo vit dhe mbrojnë shumë më tepër nga sëmundje afatgjata.

Miliona njerëz kanë bërë aktualisht vaksinat e COVID-19 në gjithë botën.

Ka prova të forta dhe të besueshme që vaksinat e COVID-19 e reduktojnë ndjeshëm rrezikun e infektimit me COVID-19. Ato janë shumë të efektshme në parandalimin e vdekjeve dhe të sëmundjeve të rënda

me COVID-19.

Nëse keni një sistem të dobët imunitar, nuk ka asnjë rrezik të shtuar nëse bëni vaksinë, por mund të mos ketë efektin e dëshiruar për ju.

### **Kur bëj vaksinën, a do të thotë se nuk do ta përhap COVID-19 tek të tjerët?**

Nuk e dimë akoma nëse bërja e vaksinës e shmang përhapjen e virusit të COVID-19 tek të tjerët. Prandaj është e rëndësishme që të gjithë bashkë të vazhdojmë të ndjekin këshillat e shëndetit publik për mënyrat e ndalimit të përhapjes së virusit.

Ajo që duhet të bëni veçanërisht është:

- ndiqni udhëzimet e distancimit social (mbani dy metra distancë nga të tjerët, nëse është e mundur)
- të vishni një mbulesë fytyre
- t'i lani duart rregullisht

**Ju falënderojmë që mbroni veten dhe të tjerët.**

### **Sa kohë zgjat imuniteti nga vakcina?**

Nuk e dimë akoma se sa do të zgjasë imuniteti. Provat

klinike po vazhdojnë për të arritur në këtë konkluzion.

### **Informacione të tjera**

Për më shumë informacion, lexoni broshurën informuese të pacientit nga prodhuesi. Ajo do të printohet e do t'ju jepet ditën e vaksinës, ose mund ta gjeni në faqen **[www.hse.ie/covid19vaccinePIL](http://www.hse.ie/covid19vaccinePIL)**

Mund të flisni rreth vaksinës edhe me një specialist të shëndetit, si mjeku juaj i familjes (doktori) ose një farmacist.

Mund të vizitoni gjithashtu faqen e internetit të HSE-së në **[www.hse.ie/covid19vaccine](http://www.hse.ie/covid19vaccine)** ose t'i telefononi HSELive në numrin **1800 700 700**.

Për më shumë informacion rreth vaksinës së COVID-19, materiale të tjera në formate të tjera dhe mbështetje me përkthime, vizitoni

**[www.hse.ie/covid19vaccinematerials](http://www.hse.ie/covid19vaccinematerials)**

### **Si t'i raportoj efektet anësore?**

Sikurse të gjitha vaksinat, efektet e dyshuara anësore mund t'i raportoni pranë Autoritetit Rregullator të

Produkteve Shëndetësore (HPRA).

HPRA është autoriteti rregullator në Republikën e Irlandës për medikamentet, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera shëndetësore. Si pjesë e rolit të saj në monitorimin e sigurisë së medikamenteve, HPRA përdor një sistem përmes së cilit specialistët e kujdesit shëndetësor ose pjesëtarë të publikut mund të raportojnë çdo reaksion të dyshuar.

HPRA inkurajon fuqishëm raportimin e reaksioneve të dyshuara negative (efektet anësorë) që lidhen me vaksinat e COVID-19 për të mbështetur monitorimin e vazhdueshëm të përdorimit të tyre të sigurt dhe efikas. Për të raportuar një reaksion të dyshuar negativ nga vakcina e COVID-19, ju lutemi të vizitoni **[www.hpra.ie/report](http://www.hpra.ie/report)**

Mund t'i kërkonti gjithashtu doktorit tuaj ose një pjesëtari të familjes që të raportojë për ju.

Duhet të jepen sa më shumë informacione të njohura, dhe kur është e mundur, duhet të përfshihet edhe numri i partisë së vaksinës.



HPRA nuk mund të ofrojë këshilla klinike për raste individuale. Pjesëtarët e publikut duhet të kontaktojnë specialistin e tyre të kujdesit shëndetësor (doktorit apo farmacistit të tyre) për çdo paqartësi mjekësore që mund të kenë.

### **Informacioni juaj personal**

Për të administruar vaksinën në mënyrë të sigurt dhe për të regjistruar gjithë informacionet e nevojshme për monitorimin dhe menaxhimin e vaksinës, HSE do të përpunojë informacionin tuaj personal. Të gjitha informacionet e përpunuara nga HSE do të jenë në përputhje me ligjet e përgjithshme dhe veçanërisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) që ka hyrë në fuqi në vitin 2018.

Përpunimi i të dhënave tuaja do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ato do të përpunohen vetëm për qëllimin specifik të menaxhimit të vaksinimeve. Është aplikuar parimi i minimizimit të të dhënave. Kjo do të thotë se regjistrohen vetëm të dhënat e nevojshme për identifikimin tuaj, prenotimin e takimit, regjistrimin e vaksinimit dhe monitorimin e efekteve përkatëse.

Si subjekt të dhënash, keni të drejtat e mëposhtme në kuadër të GDPR për të dhënat tuaja personale që janë përpunuar.

- Të kërkonti informacion për të dhënat tuaja personale dhe të keni qasje në to (që njihet si 'kërkesë për qasje nga subjekti i të dhënave').
- Kjo ju mundëson të merrni një kopje të të dhënave personale që mbajmë prej jush dhe të kontrolloni nëse po i përpunojmë në mënyrë të ligjshme.
- Të kërkonti korrigjimin e të dhënave personale që mbajmë prej jush. Kjo ju mundëson korrigjimin e çdo informacioni të paplotë ose të pasaktë që mbajmë prej jush.
- Të kërkonti fshirjen e të dhënave personale. Kjo ju mundëson të kërkonti fshirjen heqjen e të dhënave personale, nëse nuk ka më asnjë arsye që të vazhdojmë t'i përpunojmë. Keni gjithashtu të drejtën të na kërkonti të fshijmë ose të heqim të dhënat personale në rastet kur keni ushtruar të drejtën e kundërshtimit të përpunimit të tyre.
- Kundërshtimi i përpunimit të të dhënave tuaja personale.

Për më shumë informacione, vizitoni

**[www.hse.ie/eng/gdpr](http://www.hse.ie/eng/gdpr)**

## **Pasi të keni bërë vaksinë Vaxzevria (AstraZeneca) të COVID-19**

Ju falënderojmë që mbroni veten dhe të tjerët duke bërë vaksinën. Tani që keni bërë vaksinën, ju kërkohet ta lexoni këtë dokument me kujdes, në mënyrë që të dini se çfarë mund të prisni gjatë ditëve në vazhdim dhe ku mund të gjeni informacion.

Lexoni gjithashtu broshurën informuese të vaksinës së COVID-19 që ju kemi dhënë. Do t'ju japim edhe një kartelë për vaksinimin tuaj sot.

**Ju lutemi ta ruani kartelën në mënyrë të sigurt.**

## **Çfarë mund të ndodhë gjatë ditëve në vazhdim?**

Disa nga personat që kanë bërë sot vaksinën që bëtë edhe ju:

- do të kenë ndjeshmëri, ënjtje, nxirje të vendit, skuqje dhe/ose të kruara në krah, në vendin e injeksionit të vaksinës
- do të ndihen të lodhur
- do të kenë dhimbje koke
- do të kenë dhimbje të muskujve ose kyçeve
- do të kenë marrje mendsh, diarre ose të vjella
- do të kenë temperaturë (38 gradë Celsius e lart).

Ka pasur raste shumë të rralla mpiksesh gjaku të pazakonta me pllakëza të ulëta në gjak, gjatë javëve të para pas vaksinimit. Pllakëzat e ndihmojnë gjakun të mpikset.

Duhet të kërkoni ndihmën e menjëhershme të mjekut dhe të përmendni vaksinimin që keni bërë së fundmi, në rastet kur:

- keni mosmbushje me frymë
- keni dhimbje në gjoks ose në stomak
- keni ënjtje ose ndjesi të ftohti në një këmbë
- keni një dhimbje koke të fortë ose që përkeqësohet (veçanërisht 3 apo më shumë ditë pas vaksinës)
- keni turbullim të shikimit, hutim ose kriza
- keni gjakderdhje e vazhdueshme, nën lëkurë, ku nuk ka pasur lëndime të mëparshme
- keni shumë nxirje të vogla, pulla të kuqe ose ngjyrë vjollcë, ose flluska gjaku nën lëkurë.

Ka pasur një numër shumë të vogël rastesh të sindromit të rrjedhjes së kapilarëve gjatë ditëve të para pas vaksinimit. Duhet të kërkoni ndihmën e menjëhershme të mjekut dhe të përmendni vaksinimin që keni bërë së fundmi, në rastet kur:

- keni ënjtje të shpejtë e gjymtyrëve (krahëve dhe këmbëve)
- keni shtim të menjëhershëm në peshë

Mund të ndiheni gjithashtu të këputur për shkak të tensionit të ulët.

Ka pasur një numër shumë të vogël të rasteve të Sindromës Guillain Barré pas kësaj vaksine.

- keni shikim të dyfishtë ose vështirësi në lëvizjen e syve tuaj.
- keni vështirësi në qëllitje, të folur ose përthypje.
- keni probleme me koordinimin, ndiheni të pasigurt në këmbë ose keni vështirësi në ecje.
- ndjeni dobësi në krahë, këmbë, gjoks ose fytyrë.
- keni mpirje në duar dhe këmbë.
- keni probleme me kontrollin e fshikëzës dhe funksionimin e zorrëve.

Sikurse të gjitha vaksinat, efektet e dyshuara anësore mund t'i raportoni pranë Autoritetit Rregullator të Produkteve Shëndetësore (HPRA). Për të raportuar efektet anësore nga vaksina e COVID-19, ju lutemi të vizitoni **[www.hpra.ie/report](http://www.hpra.ie/report)**

### **Po nëse kam temperaturë ose dhimbje?**

Nëse keni temperaturë ose dhimbje të ngjashme me ato të gripit, mund të pini paracetamol ose ibuprofen për lehtësim. Megjithatë, nëse temperatura zgjat më shumë se 48 orë ose nëse jeni ende të shqetësuar, kërkoni këshillë mjekësore. Mos merrni ibuprofen nëse jeni shtatzënë.

### **A duhet të bëj ndonjë gjë para se të bëj dozën e dytë të vaksinës?**

Kur të bëni dozën tjetër dhe të fundit të vaksinës, thojini ekipit të vaksinimit nëse ka pasur ndryshime në historikun tuaj mjekësor.

### **Ju lutemi ta merrni me vete kartelën tuaj të vaksinimit kur të shkoni për të bërë dozën e dytë.**

### **Pas vaksinimit**

Bërja e vaksinës së COVID-19 duhet t'ju mbrojtë nga komplikacionet e rënda të COVID-19.

Do të keni mbrojtjen më të mirë 15 ditë pas dozës tuaj të dytë. Do të merrni dozën tuaj të dytë midis 4 dhe 12 javëve pas dozës tuaj të parë.

Ekziston mundësia që të infektoheni me COVID-19, edhe nëse keni bërë vaksinën.

Nuk e dimë akoma nëse bërja e vaksinës e shmang përhapjen e virusit tek të tjerët, prandaj duhet të vazhdoni të ndiqni këshillat e shëndetit publik:

- të ndiqni udhëzimet për distancimin social
- (të mbani dy metra distancë nga të tjerët, nëse është e mundur)
- të vishni një mbulesë fytyre
- t'i lani duart rregullisht.

### **Keni pyetje?**

Nëse jeni të pasigurt për diçka apo nëse keni pyetje për vaksinën e COVID-19, ju lutemi pyesni vaksinuesin tuaj sot.

Vizitoni **[www.hse.ie/covid19vaccine](http://www.hse.ie/covid19vaccine)** për më shumë informacione rreth vaksinës së COVID-19.

### **Efektet anësore**

Ju lutemi t'i raportoni efektet anësore pranë HPRA në **[www.hpra.ie/report](http://www.hpra.ie/report)**.



**Publikuar nga HSE më 28 korrik 2021**

Për informacionin më të azhurnuar vizitoni **[www.hse.ie](http://www.hse.ie)**



Rialtas na hÉireann  
Government of Ireland